

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8319
E premte, 12 qershor 2026
Çmimi 0.50 €

Cilët kandidatë për deputetë kanë më shumë vota?

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NË MARSHIN E UÇK-SË, VETERANËT KËRKOJNË LIRIMIN E ÇLIRIMTARËVE NË HAGË: LUFTA JONË ISHTE E DREJTË

FAQE 4-5



Në kuadër të shënimit të Ditës së Çlirimit të Prishtinës, ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të veshur me uniformat e UÇK-së, kanë marshuar

nëpër sheshet e kryeqytetit, ndërsa kanë kërkuar lirimin e ish-krejtësve të UÇK-së që po gjykohej në Hagë. Ata thanë se lufta e UÇK-së ishte e drejtë

dhe se ish-drejtuësit e saj po përballen padrejtësisht me procesin gjyqësor në Hagë, ndërsa thanë se shpresojnë që ata të kthehen sa më shpejt në Kosovë



'TEATRI PRAPA PERDEVE', EKSPERTËT BRITANIKË PËRMENDIN VEPRIMET E TRENDAFILOVËS NË DËM TË LIDERËVE TË UÇK-SË

F.3

PD-ja THOTË SE BERISHËS IU HOQ NDALESA AMERIKANE, DASH-I ENDE PA KONFIRMIM PUBLIK

.8



AKTUALE



TRUMPI PARALAJMËRON SE IRANI "DO TA PAGUAJË ÇMIMIN" NËSE VONOHET TË ARRIJË NJË MARRËVESHJE

F.2

GJYKATA SUPREME SHFUQIZON PJESËRISHT RREGULLAT PËR XHAMAT E ERRËT

F.7

IKD, AGK DHE KMSHK: VENDIMET E KPM-SË PO CENOJNË SERIOZISHT LIRINË E MEDIEVE NË KOSOVË

F.6

EKONOMI



BQK-ja DHE THESARI I SHBA-SË THELLOJNË BASHKËPUNIMIN PËR AML/CFT

F.8

BQK-ja DHE ATK-ja NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR AVANCIMIN E SHKËMBIMIT TË INFORMACIONIT DHE FORCIMIT E INTEGRITETIT FINANCIAR

F.8

SPORT



"DARDANET" U17 DHE U19 MËSOJNË KUNDËRSHTARET PËR KUALIFIKIMET EVROPIANE

F.11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI PARALAJMËRON SE IRANI 'DO TA PAGUAJË ÇMIMIN' NËSE VONOHET TË ARRIJË NJË MARRËVESHJE

WASHINGTON, 11 QERSHOR - Presidenti amerikan Donald Trump tha se ushtria e Iranit është "mposhtur krejtësisht", duke paralajmëruar se Teherani "do ta paguajë çmimin" për shkak se merr shumë "kohë për të negociuar një marrëveshje" me Uashingtonin.

Deklaratat e udhëheqësit amerikan vijnë në kohën e përshkallëzimit të tensioneve mes dy shteteve.

Përmes një postimi në "Truth Social" më 10 qershor, Trumpi i përshkroi forcat e armatosura iraniane si "katrahurë të vërtetë", duke pretenduar se shumica e forcave detare dhe ajrore të shtetit "nuk ekzistojnë më".

Po ashtu, ai vlerësoi se Irani "ka vetëm fjalë e asnjë vepër" dhe e cilësoi Republikën Islamike si



"ngacmuese të Lindjes së Mesme". Deklaratat vijnë pasi forcat amerikane kryen sulme ndaj

sistemeve të mbrojtjes ajrore, radarëve dhe vendeve për vëzhgim të Iranit mbrëmjen e 9

qershorit. Sulmet u kryen afër Ngushticës së Hormuzit dhe Uashingtoni tha se ato ishin në përgjigje të rrëzimit të helikopterit të ushtrie amerikane të llojit Apache.

Irani më pas lëshoi raketa dhe dronë drejt caqeve të lidhura me ShBA-në në Jordani dhe në të gjithë Gjirin Persik, ndonëse zyrtarët amerikanë thanë se shumica u penguan.

Pavarësisht prej shkëmbimit të fundit të sulmeve, Trumpi ka përsëritur se një marrëveshje e negociuar mund të arrihet. Megjithatë, në një intervistë për "Fox News" më 10 qershor, Trumpi tha se ishte afër autorizimit të sulmeve të tjera ndaj infrastrukturës iraniane, përfshirë ndaj termocentraleve dhe urave, nëse Teherani do të

refuzonte të nënshkruante një marrëveshje.

Agjencia e lajmeve "Reuters" raportoi se negociatorë nga Katar i udhëtuan drejt Iranit më 10 qershor, pas konsultimeve me Uashingtonin, në një përpjekje për të finalizuar një marrëveshje. Sipas "Fox News", Trumpi tha se Irani ende ka një mundësi për të arritur marrëveshje, por sugjeroi se veprime të mëtejshme ushtarake mbeten opsion nëse negociatat do të vazhdojnë të mos prodhojnë ndonjë rezultat.

Këmbimi i sulmeve mes ShBA-së dhe Iranit shënon një nga përshkallëzimet më serioze që kur Uashingtoni dhe Teherani u pajtuan për një armëpushim në prill, pasi ShBA-ja dhe Izraeli nisën sulmet e përbashkëta ndaj Iranit në fund të shkurtit.

SHBA-ja DHE IRANI SHKËMBEJNË SULME AJRORE NË DITËN E DYTË RADHAZI

TEHRAN, 11 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara e kryen një raund të ri sulmesh ajrore ndaj shënjestrave ushtarake në Iran më 10 qershor, duke nxitur Teheranin të kryejë sulme hakmarrëse kundër shënjestrave ushtarake amerikane në Bahrejn dhe Kuvajt.

Komanda Qendrore e ShBA-së, CENTCOM, tha se forcat e saj kryen sulme të tjera "vetëmbrojtëse", duke goditur kapacitetet iraniane të mbikëqyrjes ushtarake, sistemet e komunikimit dhe pozicionet e mbrojtjes ajrore në mbarë Iranin.

Operacioni përfshiu mjete të Korpusit të Marinës së ShBA-së, Forcave Ajrore dhe Marinës Ushtarake, të cilat përdorën municione me precizitet të lartë kundër caqeve që Uashingtoni tha se përbënin kërcënim për forcat amerikane dhe për transportin tregtar ndërkombëtar në ujërat e rajonit. "Sulmet janë përgjigje ndaj agresionit të pajustificuar dhe të vazhdueshëm të Iranit", tha CENTCOM në një deklaratë në orët e para të 11 qershorit, duke shtuar se forcat amerikane janë "syhapur, të fuqishme dhe të gatshme".

Menjëherë pas kësaj, Trupat e Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC) njoftuan se kishin goditur shënjestrat ushtarake amerikane në Bahrejn dhe Kuvajt si kundërpërgjigje ndaj sulmeve amerikane.

Në një deklaratë, IRGC tha se kishte goditur 18 caqe të lidhura me ushtrinë amerikane në dy valë operacionesh kundër bazave ajrore "Ali Al Salem" dhe

"Ahmed Al Jaber" në Kuvajt. Sipas tyre, forcat iraniane goditën gjithashtu bazën ajrore "Sheikh Isa" në Bahrejn.

Zyrtarët amerikanë nuk kanë njoftuar për shkallën e dëmeve të mundshme, ndërsa ndikimi i sulmeve mbeti i paqartë.

Ministria e Brendshme e Bahrejnit tha se sirenat për sulme ajrore ranë në gjithë mbretërinë e Gjirit për herë të dytë dhe u bëri thirrje qytetarëve dhe banorëve të qëndrojnë të qetë dhe të lëvizin drejt vendit më të afërt të sigurt.

Ndërkohë, autoriteti i aviacionit civil të Kuvajtit njoftoi më 11 qershor se hapësira ajrore e vendit është rihapur dhe se trafiku komercial është "kthyer në normalitetit", pasi një seri sulmesh iraniane shkaktoi mbylljen e tyre të përkohshme. Përplasja e fundit përbën përshkallëzim të ndjeshëm të konfrontimit midis Uashingtonit dhe Teheranit, duke rritur shqetësimet për paqëndrueshmëri më të gjerë në rajonin e Gjirit dhe për kërcënime ndaj infrastrukturës energjetike dhe rrugëve tregtare detare.

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, bëri thirrje për ndalimin e menjëhershëm të armiqësive, duke paralajmëruar se Lindja e Mesme po zhytet "gjithnjë e më thellë në krizë" dhe se pasojat shtrihen shumë përtej rajonit.

Një ditë më parë sulmet ajrore amerikane goditën disa shënjestra në Iran si përgjigje ndaj Iranit për rrëzimin e një helikopteri të ushtrisë amerikane në Ngushticën e Hormuzit. Më



pas, Irani kreu sulme ndaj bazave amerikane në rajon, në një kundërpërgjigje.

Sulmet e 10 qershorit ndodhën vetëm pak orë pasi presidenti amerikan Donald Trump u tha gazetarëve se "ne i goditëm fuqishëm dje dhe do t'i godasim përsëri fuqishëm sot".

Para sulmeve ajrore, presidenti iranian Masoud Pezeshkian tha në X se vendi i tij do t'i bënte ballë çfarëdo trysnie dhe se kërcënimet e Trumpit ishin shenjë e dëshpërimit të Uashingtonit.

Duke folur para gazetarëve, Trumpi pretendoi se Shtetet e Bashkuara kanë marrë naftë nga Irani. "Po e bëj publike sot për herë të parë, por ne kemi nxjerrë miliona fuçi naftë, miliona fuçi çdo natë", tha Trumpi, duke shtuar se Irani "vetëm tani e ka kuptuar këtë".

Lidhur me negociatat me Iranin, Trumpi shtoi: "Ne duam

marrëveshje që ka kuptim, duam një marrëveshje që funksionon. Ishim shumë pranë një marrëveshjeje, por ata vazhdojnë të na zvarrisin, vazhdojnë të luajnë me ne sikur të ishim budallenj".

Trumpi tha se Irani tashmë është pajtuar për të mos zhvilluar armë bërthamore – një nga kërkesat kryesore të Uashingtonit – por marrëveshja nuk është nënshkruar ende.

Më herët të mërkurën, bordi i guvernatorëve me 35 anëtarë i mbikëqyrësit bërthamor të OKB-së miratoi një rezolutë të mbështetur nga ShBA-ja, e cila kërkon që Irani t'i tregojë rezervat e mbetura të uraniumit të pasuruar dhe t'i lejojë inspektorët të hyjnë në vend. Ambasadori iranian në Austri, Reza Najafi, i tha AFP-së se rezoluta është "kundërproduktive" dhe pengesë për bisedimet me

Uashingtonin.

Më herët, Trumpi deklaroi se ushtria iraniane është "mposhtur plotësisht", duke paralajmëruar Teheranin se do ta "paguajë çmimin" për faktin se "po vonohet shumë për ta negociuar një marrëveshje" me Uashingtonin.

Teherani dhe Uashingtoni janë përfshirë në negociatat që prej 8 prillit, kur një armëpushim i dha fund fushatës së bombardimeve amerikano-izraelite kundër Iranit.

Megjithatë, disa çështje të ndërlikuara kanë penguar arritjen e një marrëveshjeje, përfshirë fatin e rezervave iraniane të uraniumit të pasuruar, luftën e vazhdueshme të Izraelit kundër Hezbollahut në Liban dhe kërkesën e Teheranit që Uashingtoni t'i lirojë fondet iraniane të ngrira jashtë vendit.

PD-ja THOTË SE BERISHËS IU HOQ NDALESA AMERIKANE, DASH-I ENDE PA KONFIRMIM PUBLIK

TIRANË, 11 QERSHOR - Partia Demokratike e Shqipërisë deklaroi se Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) ka hequr sanksionimin që i ndalonte hyrjen në territorin amerikan kreut të kësaj partie, Sali Berisha. Ambasada Amerikane në Tiranë nuk ka dhënë asnjë koment, ndërsa Partia Demokratike ka deklaruar se vendimi është marrë, por ende nuk është shpallur zyrtarisht nga institucionet amerikane. Radio Evropa e Lirë i është drejtuar DASH-it për ta konfirmuar pohimin e PD-së lidhur me çështjen e Berishës.

Më 19 maj të 2021-shit, DASH-i ia ndaloj hyrjen në territorin amerikan ish-presidentit dhe ish-kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha dhe anëtarëve të familjes së tij të ngushtë, për shkak të përfshirjes së tij në korrupsion të gjerë. Sekretari amerikan i Shtetit në atë kohë, Antony Blinken, tha se Berisha, në cilësinë e tij zyrtare, në veçanti si kryeministër i Shqipërisë, ishte i përfshirë në veprime korruptive, të tilla si shpërdorim i fondeve publike dhe ndërhyrje në proceset publike.

Kryetari i PD-së, Sali Berisha, hyri në sallën e Kuvendit të enjten duke deklaruar: "Unë erdha, u krye". I pyetur nga gazetarët, Berisha tha se ka pasur komunikim zyrtar nga autoritetet amerikane, por nuk tha se kush ia ka komunikuar. "Sali Berisha nuk ka qenë kurrë non grata [person i padëshiruar]. Ka pasur një sanksion, vizën. Kundërshtarët e mi e quajtën non grata dhe unë nuk është se e kundërshtova", tha Berisha ndërsa nuk iu përgjigj gazetarëve nëse sanksionimi është hequr edhe për familjarët e tij.

Sipas DASH-it, ish-kryeministri shqiptar përdori pushtetin e tij për përfitimet dhe për t'i pasuruar aleatët e tij politikë dhe anëtarët e familjes së tij. Për këtë arsye iu ndalua hyrja në ShBA Berishës, bashkëshortes së tij, Liri Berisha, djalit të tij, Shkelzen Berisha dhe vajzës, Argita Berisha Malltezi.

Pas deklaratave nga Berisha dhe Partia Demokratike, reagoi kreu

i grupit parlamentar i Partisë Socialiste, Taulant Balla. "Statusi 'non grata' është vendosur mbi bazën e seksionit 7031(c). Në vlerësimin tim është pak vështirë të hiqet. Unë do ta komentoj vetëm kur të ketë një njoftim zyrtar nga DASH-i ose nga Ambasada Amerikane. Nuk komentoj biseda telefonike, sepse nuk është korrekte dhe nuk është institucionale", tha Balla.

Çfarë ndodhi pas vendimit të DASH-it më 2021?

Menjëherë pas vendimit të DASH-it për Berishën, drejtuesit e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e njohur si SPAK, deklaruan se çdo material apo indicie që do të vihej në dispozicion do të hetohej.

Në vitin 2023 SPAK-u kërkoi masë sigurie ndaj Berishës në dosjen e njohur si çështja "Partizani", ku kishte dyshime se kishte përdorur ndikimin e tij si kryeministër për ta favorizuar dhëndrin e tij, Jamarbër Malltezi, në privatizimin dhe zhvillimin e një prone në Tiranë. Berisha u detyrua fillimisht të paraqitej periodikisht para autoriteteve dhe të mos largohej nga vendi. Në fund të vitit 2023, pasi nuk zbatoi detyrimin e paraqitjes, Gjykata e Posaçme vendosi ndaj tij masën e arrestit shtëpiak. Në shtator 2024, SPAK-u e mori zyrtarisht të pandehur për korrupsion pasiv dhe dosja kaloi për gjykim. Në nëntor 2024, arresti shtëpiak u hoq, por procesi gjyqësor vazhdoi. Në korrik 2025 nisi gjykimi në Gjykatën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Berisha i ka mohuar akuzat dhe i ka cilësuar të motivuara politikisht.

Vendimi i DASH-it pati ndikim edhe në aspektin politik. Në shtator të vitit 2021, kryetari i atëhershëm i PD-së, Lulzim Basha, e përjashtoi Berishën nga grupi parlamentar i PD-së, duke argumentuar se ky ishte një vendim për t'i ruajtur marrëdhëniet me ShBA-në. Berisha nisi "Foltoren" - takime me anëtarët dhe simpatizantët demokratë në të gjithë Shqipërinë, duke sfiduar drejtësinë e Bashës. Në fund të



vitit 2021, përplasja solli ndarjen e PD-së në dy kampe dhe zhvillimin e dy kuvendeve të ndryshme.

Gjatë vitit 2022 Basha dha dorëheqje dhe Berisha u rikthye në krye të Partisë Demokratike, duke fituar zgjedhjet për kryetar. Edhe gjatë kohës kur ishte nën hetim dhe më pas në arrest shtëpie, Berisha vazhdoi ta drejtonte PD-në.

Kush është Sali Berisha?

Sali Berisha është presidenti i parë i Shqipërisë pas rrëzimit të totalitarizmit 50-vjeçar të Shqipërisë. Ardha e tij në krye të vendit në vitin 1992 shënoi hapjen e parë të Shqipërisë drejt demokratizimit dhe një epokë të re në marrëdhëniet e Shqipërisë me botën, përfshirë ShBA-në.

Berisha ishte presidenti i parë i Shqipërisë që pas gjysmë shekulli u prit për herë të parë nga një president amerikan në Zyrën Ovale në Shtëpinë e Bardhë nga George Bush.

Në kohën sa Berisha ishte kryeministër, më 2007, Shqipërinë e vizitoi presidenti amerikan George W. Bush, prej ku dhe shprehu përkrahjen për pavarësinë e Kosovës. Tetë muaj pas vizitës së Bushit në Shqipëri, Kosova shpalli pavarësinë.

Në mandatin e parë si president i vendit, Berisha mbikëqyri ndryshimet e mëdha shoqërore - nga një shoqëri e mbyllur në kalimin drejt një shoqërie me treg të hapur dhe reforma demokratike.

Ai mbikëqyri krijimin e institucioneve, hartimin e Kushtetutën e Shqipërisë si

Republikë demokratike dhe u përball me sfidat e tranzicionit që pa një numër të madh të shqiptarëve që migronin drejt vendeve të Bashkimit Evropian, për t'i ikur varfërisë.

Pika më kundërtënëse e qeverisjes së tij në mandatin e dytë si president ishte lejimi i funksionimit të skemave piramidale, kolapsimi i të cilave e çoi Shqipërinë në luftë civile, pasi një numër i madh i qytetarëve humbën kursimet jetësore me vlerë 1.2 miliard dollarë.

Në vitin 1997 shteti i Shqipërisë kolapsoi ekonomikisht dhe politikisht dhe vendi u zhyt në anarki, me qytetarët që thyen depot e armëve për t'i përdorur ato kundër fraksioneve të ndryshme komunitare. Konflikti civil në Shqipëri la mbi 2 mijë persona të vdekur. Kjo çoi në dorëheqjen e Berishës si president në vitin 1997, duke i hapur rrugë mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme dhe krijimit të një qeverie teknike, e cila kishte për qëllim stabilizimin e Shqipërisë.

Në këtë periudhë Berisha vazhdoi të luajë rol të rëndësishëm në politikën shqiptare, si kreu i opozitës deri në vitin 2005, kur partia e tij fitoi zgjedhjet dhe ai u bë kryeministër. Gjatë mandatit të tij kryeministër, Berisha synoi ta bëjë Shqipërinë anëtare të NATO-s dhe më 2009, Shqipëria iu bashkua Aleancës Veri-Atlantike.

Në mes të mandatit të tij kryeministër, në periudhën 2005-2013, kur Partia Demokratike ishte rikthyer për ta qeverisur Shqipërinë,

Shqipëria u trondit nga shpërthimi i një depoje të armëve ushtarake në Gërdec, në afërsi të Tiranës.

Njëzet e gjashtë persona, përfshirë fëmijë, mbetën të vdekur teksa po përpunonin armatimin e vjetër të periudhës komuniste, si pjesë e një kontrate me një kompani private që po furnizonte këtë lloj armatimi për ushtrinë afgane, pas ndërhyrjes amerikane në Afganistan.

Hulumtime të shumta e kanë nxjerrë Berishën, familjarët dhe persona të tjerë të afërt në qendër të këtij incidenti me përmasa ndërkombëtare, me djalin e tij që besohet të ketë qenë pjesë e kësaj kontrate. Në vitin 2013 Berisha dha dorëheqje si kryetar i Partisë Demokratike, pasi partia e tij humbi zgjedhjet.

Problemet me ndërkombëtarët

Qeverisja e Berishës, sikurse edhe e rivalëve të tij politikë, është përcjellë me tensione të cilat shpeshherë, është vlerësuar se kanë minuar progresin e Shqipërisë në përmbytjen e reformave demokratike, në veçanti rreth sundimit të ligjit. Përgjatë karrierës së tij, Sali Berisha ka pasur përplasje me faktorin ndërkombëtar për ndërhyrje në drejtësi - në vitin 1995 kur shkarkoi gjyqtarin Zef Brozi nga Gjykata e Lartë dhe arrestimin e liderëve të minoritetit grek në Tiranë.

Përplasja u thellua në maj 1996 ku ShBA-ja nuk njohu zgjedhjet e përgjithshme, në të cilat u përdor dhunë mbi opozitën dhe ku komisionarët e saj u larguan nga qendrat e votimit.

Më pas në 21 janar 2011, ShBA-ja angazhoi Byronë Federale të Hetimeve (FBI) për të kryer verifikimet shkencore të plumbave që vranë katër persona në protestat e Partisë Socialiste, që në atë kohë ishte në opozitë.

Një përplasje tjetër ishte mbi reformën në drejtësi - ku ambasadori amerikan i asaj kohe bëri përpjekje për të bindur palët për të miratuar ndryshimet kushtetuese. Berisha kishte thënë se ambasadorët me mision në Shqipëri, po silleshin si guvernatorë.

Komandanti i KFOR-it flet për sigurinë në Kosovë: Nuk ka kërcënime të drejtpërdrejta

Prishtinë, 11 qershor - Në një intervistë për "Përballje Podcast" në Telegraf, komandanti i KFOR-it në Kosovë, gjeneralmajori Ozkan Ulutash, ka deklaruar se situata e përgjithshme e sigurisë në Kosovë mbetet e qetë dhe se aktualisht nuk ka tregues për kërcënime të drejtpërdrejta ndaj sigurisë, megjithëse ka paralajmëruar se tensionet e

pazgjidhura, retorika nxitëse dhe dezinformimi vazhdojnë të paraqesin sfida që kërkojnë vigjilencë të vazhdueshme.

Në intervistë me kryeredaktorin e Telegrafit, Muhamet Hajrullahu, Ulutash tha se KFOR-i mbetet plotësisht i gatshëm për t'iu përgjigjur çdo përkeqësimi të mundshëm të situatës, duke theksuar se misioni i NATO-s

është i pajisur, i trajnuar dhe i pozicionuar për të reaguar shpejt në rast nevoje.

Duke folur për situatën në veri, komandanti i KFOR-it vlerësoi se aktualisht gjendja është e qetë dhe se nuk janë regjistruar incidente të ngjashme me ato të vitit 2023, por nënvizoi se misioni nuk po e ul vigjilencën për shkak të çështjeve të pazgjidhura dhe ndikimit që



mund të kenë dezinformimi dhe retorika e papërgjegjshme në terren.

Ai theksoi se KFOR-i vazhdon koordinimin e ngushtë me institucionet e sigurisë në Kosovë, EULEX-in dhe autoritetet përkatëse në rajon, ndërsa përsëriti se stabiliteti afatgjatë në Kosovë nuk mund të arrihet përmes zgjidhjeve ushtarake, por përmes dialogut politik për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.



NË MARSHIN E UÇK-së, VETERANËT KËRKOJNË LIRIMIN E ÇLIRIMTARËVE NË HAGË: LUFTA JONË ËSHTË E DREJTË

Në kuadër të shënimit të Ditës së Çlirimit të Prishtinës, ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të veshur me uniformat e UÇK-së, kanë marshuar nëpër sheshet e kryeqytetit, ndërsa kanë kërkuar lirimin e ish-krerëve të UÇK-së që po gjykohej në Hagë. Ata thanë se lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe se ish-drejtuesit e saj po përballen padrejtësisht me procesin gjyqësor në Hagë, ndërsa thanë se shpresojnë që ata të kthehen sa më shpejt në Kosovë.

Prishtinë, 11 qershor (ER) - Në kuadër të shënimit të Ditës së Çlirimit të Prishtinës, ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të veshur me uniformat e UÇK-së, kanë marshuar të enjten nëpër sheshet e kryeqytetit, ndërsa kanë kërkuar lirimin e ish-krerëve të UÇK-së që po gjykohej në Hagë.

Ata thanë se lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe se ish-drejtuesit e saj po përballen padrejtësisht me procesin gjyqësor në Hagë, ndërsa thanë se shpresojnë që ata të kthehen sa më shpejt në Kosovë.

Veterani invalid i luftës së UÇK-së, Asllan Doshi, i njohur si zëvendëskomandant Togu, tha se marshi dhe përkujtimi i luftës çlirimtare janë shprehje respekti për veteranët, invalidët dhe të gjithë ata që kontribuan në çlirimin e vendit. "Lufta e UÇK-së ishte e drejtë. Ne besojmë se lirimi i tyre duhet me qenë i menjëhershëm, sepse është gjykim i padrejtë i luftës tonë çlirimtare", tha ai.

Edhe veterani i luftës së UÇK-së, Hajzer Bistrica, kujtoi angazhimin e tij gjatë luftës, duke thënë se ka shërbyer në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës që nga ditët e para deri në çlirimin e vendit.



Bistrica tha se ndihet krenar që është dëshmitar i gjallë i sakrificës së luftës dhe se emocionet e kësaj dite janë të papërshkrueshme. "Kam shërbyer në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës qysh prej ditëve të para e deri në ditën e çlirimit. Jam pjesëmarrës që kam bartur armatim prej Shqipërisë për në Kosovë për t'ju ndihmuar sado pak ushtarëve, të cilët nuk kanë pasur mundësi me marrë rrugën. Jemi krenarë për atë periudhë. Jam krenar që sot e arrita këtë ditë, dhe jam dëshmitar i gjallë i asaj sakrifice që ka ndodhur. Janë të papërshkrueshme gëzimi dhe emocionet që kam sot", tha ai. Duke folur për ish-krerët e UÇK-së që po gjykohej në Hagë,

Bistrica tha se ata nuk do të duhej të përballeshin me atë proces dhe se pret kthimin e tyre sa më shpejt në Kosovë. "Ata në radhë të parë s'do duhej me i marrë hiq atje, po me propaganda të armikut ata janë atje. Presim sa më shpejt që të vijmë në mesin tonë, sepse ata janë kupola e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", tha ai. Komandanti i Zonës së Pestë Operative Llap-Gollak, Islam Kelmendi, tha se uniformat e UÇK-së mbetet simbol i shenjtë

për luftëtarët dhe se çdo paraqitje me të zgjon emocionet e kohës së luftës.

Ndërsa, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka falënderuar veteranët e UÇK-së për pjesëmarrjen në marsh, duke thënë se aktiviteti u organizua në shenjë përkujtimi të sakrificës së dëshmorëve dhe familjeve që kontribuan për lirinë e vendit. "I falënderoj shumë veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që sot na u kanë bashkuar. Kemi bërë një



“TEATRI PRAPA PERDEVE”, EKSPERTËT BRITANIKË PËRMENDIN VEPRIMET E TRENDAFILOVËS NË DËM TË LIDERËVE TË UÇK-së

HAGË, 11 QERSHOR - Kur një gjyqtar i Apelit në Gjykatën Speciale, Kai Ambos, kishte folur për mundësinë që Hashim Thaçi të lirohej për mbrojtje në liri në një vend të tretë, kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, e kishte ndryshuar panelin e gjyqtarëve. Kai Ambos ishte larguar. Kjo është një nga praktikat shqetësuese në një gjykatë që synon të ndajë drejtësi, e cila është përmendur të enjten në Hagë nga ekspertët e organizatës “The Bar Human Rights Committee of England and Wales” (BHRC), gjatë prezantimit të raportit për Gjykatën Speciale. Raporti i tyre, prej 90 faqesh, ka konstatuar shkelje të të drejtave të të akuzuarve në procesin gjyqësor ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Një tjetër aspekt shqetësues, që u përmend nga hulumtuesit Gus Waschefort dhe Lauren Lederle, ishte koha e gjatë e

marrjes në pyetje nga ana e gjyqtarëve, krahasuar me kohën që u jepej palëve mbrojtëse të ish-krerëve të UÇK-së. Kjo, sipas tyre, detyronte mbrojtjen të shpenzonte orë të tëra për të sqaruar çështje të ngritura nga gjyqtarët gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve. Ndërkohë, prokuroria shfrytëzonte vetëm pak minuta për t’iu përgjigjur çështjeve të ngritura nga gjyqtarët. Sipas hulumtuesve, kjo nënkupton mungesë të barazisë së armëve ndërmjet palëve, një parim i garantuar nga standardet ndërkombëtare të drejtësisë. Në konferencë, hulumtuesit e BHRC-së kanë përmendur edhe raste kur gjyqtarët, veçanërisht Guénaël Métraux, kanë bërë pyetje sugjestive gjatë seancave gjyqësore. Takimi i dhjetorit 2020 mes Ekaterina Trendafilovës dhe prokurorit Jack Smith me



ambasadorë të Bashkimit Evropian është cilësuar nga hulumtuesit britanikë si diçka e pazakontë. Sipas tyre, deklaratimet e bëra aty lidhur me lirimin ose jo të krerëve të UÇK-së përbëjnë cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë. Gjatë prezantimit të raportit është konstatuar po ashtu se dokumentet e siguruar nga

Serbia dhe pranimit i një pjese të madhe të tyre pa një procedurë të plotë testimi dhe verifikimi kanë qenë ndër kontestimet kryesore. Hulumtuesit kanë theksuar se pranimit i këtyre dokumenteve është problematik, duke pasur parasysh qëndrimin e Serbisë ndaj Kosovës. Sipas raportit të BHRC-së, prokuroria ka përdorur rreth 2354 dokumente

të siguruar nga Serbia. Në këtë konferencë në Hagë janë ftuar edhe përfaqësues të Gjykatës Speciale. Megjithatë, askush nga përfaqësuesit e saj nuk është paraqitur. Ftesën drejtuar Gjykatës Speciale e ka konfirmuar gjatë konferencës Avokati i Popullit i Kosovës, Naim Qelaj, në fjalën e tij hapëse. Qelaj ka theksuar se raporti është autentik dhe i pavarur, i hartuar nga organizata BHRC pa asnjë ndërhyrje nga institucionet e Kosovës apo nga ndonjë instancë tjetër. Të pranishëm në këtë konferencë kanë qenë diplomatë të vendeve të Bashkimit Evropian, si dhe përfaqësues të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Hagë. Kujtojmë se zyrtarë të Gjykatës Speciale ndonëse janë ftuar të marrin pjesë në këtë konferencë, por të njëjtin nuk janë paraqitur, duke refuzuar pjesëmarrjen. (Vox Kosova)

marsh si shenjë e përkujtimit të sakrificës së madhe, të vlerave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe të secilit dëshmor, të secilës familje që ka sakrifikuar çdo gjë që sot ta kemi lirinë, demokracinë, që sot të bëhemi bashkë e të planifikojmë për të ardhmen e vendit tonë. Urime 11 Qershori, Dita e Çlirimit të kryeqytetit! Faleminderit shumë veteranëve! Lavdi të gjithë dëshmorëve dhe familjeve që kanë dhënë çdo gjë që sot të jemi të lirë e ta festojmë këtë ditë të mrekullueshme në paqe”, tha Rama.

Veterani i UÇK-së vendos fotografitë e ish-krerëve që po mbahen në Hagë para Qeverisë

Veterani i UÇK-së, Agim Pllashniku, ka zhvilluar një aksion simbolik para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës në Ditën e Çlirimit të Prishtinës, duke vendosur fotografitë e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që po gjykohej në Hagë, me

mbishkrimin “Ne jemi çlirimtarë, jo zullumçarë”. Pllashniku tha se aksioni kishte për qëllim të përcillte një mesazh për kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, lidhur me ish-drejtesit e UÇK-së që po përballen me proces gjyqësor në Hagë.



CILËT KANDIDATË PËR DEPUTETË KANË MË SHUMË VOTA?

Prishtinë, 11 qershor - Katër ditë pas mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë po vazhdon, duke qartësuar se kush do të jetë pjesë e legjislaturës së njëmbëdhjetë të Kuvendit të Kosovës. Deri më tani, sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë numëruar pothuajse të gjitha votat e hedhura në kuti. Më poshtë paraqiten kandidatët që kanë siguruar mbështetjen më të madhe të votuesve në secilën prej katër partive kryesore politike shqiptare, pasi janë numëruar mbi 84 për qind e votave.

Lëvizja Vetëvendosje

Albin Kurti: 202.448 vota
Glauk Konjufca: 159.156 vota

Albulena Haxhiu: 92.727 vota
Hekuran Murati: 80.160 vota
Donika Gërvalla-Schwarz: 75.476 vota

Partia Demokratike e Kosovës

Bedri Hamza: 100.885 vota
Përparim Gruda: 62.064 vota
Arian Tahiri: 54.089 vota
Uran Ismaili: 48.533 vota
Sala Jashari: 33.702 vota

Lidhja Demokratike e Kosovës

Vjosa Osmani Sadriu: 67.208 vota
Lumir Abdixhiku: 61.058 vota
Doarsa Kica Xhelili: 47.472 vota
Hykmete Bajrami: 37.646 vota
Avdullah Hoti: 34.337 vota

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

Ardian Gjini: 35.289 vota
Ramush Haradinaj: 31.889 vota



Daut Haradinaj: 24.107 vota
Besnik Tahiri: 20.733 vota
Bekë Berisha: 17.327 vota

Sipas rezultateve preliminare të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje (LV) e

kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, doli e para në zgjedhjet e 7 qershorit me 42.91 për qind të votave. Pas saj renditen Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 21.14 për qind, Lidhja Demokratike e Kosovës

(LDK) me 17.60 për qind, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me 7.16 për qind dhe Lista Serbe me 6.17 për qind. Sipas të dhënave paraprake, LV-ja do t’i ketë 48 vende në Kuvend, e ndjekur nga PDK-ja me 24, LDK-ja me 20 dhe AAK-ja me 8. KQZ-ja duhet t’i numërojë edhe votat me kusht, të personave me nevoja të veçanta si dhe ato me postë dhe të diasporës që ka votuar në përfaqësi diplomatike të Kosovës. Ky institucion planifikon që t’i shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve më 26 qershor dhe t’i certifikojë më 6 korrik, por këto afate janë vetëm planifikime, pasi do të varet edhe nga ankesat që mund të ushtrojnë palët lidhur me procesin.

IKD, AGK DHE KMSHK: VENDIMET E KPM-SË PO CENOJNË SERIOZISHT LIRINË E MEDIEVE NË KOSOVË

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës kanë dënuar fuqishëm deklarimin e nënkryetares së Komisionit të Pavarur të Medieve, Drita Morina, e cila, pa asnjë mbështetje në Kodin e Etikës të KPM-së, ka paralajmëruar mbylljen e emisionit "Debat Plus" në RTV Dukagjini.

Instituti i Kosovës për Drejtësi ka njoftuar se është duke përcjellë me shqetësim të thellë vendimmarrjen e fundit të Komisionit të Pavarur të Medieve (KPM), përmes së cilës ky institucion është duke cenuar seriozisht lirinë e medieve në Kosovë. Sipas IKD-së, këto vendime paraqesin tejkalim të mandatit ligjor të KPM-së dhe krijojnë standard të rrezikshëm për funksionimin e medieve, debatit publik dhe demokracisë. "Në vendimmarrjen e saj, KPM është duke marrë kompetenca që nuk i takojnë rregullatorit, por gjykatës. Përmes këtyre vendimeve, KPM po shqipton sanksione ndaj medieve për deklarata të personave të tretë, të dhëna në debate televizive, duke ua mveshur mediave përgjegjësi automatike për çdo fjalë të të ftuarve. Një qasje e tillë është e kundërligjshme dhe e papranueshme në një shoqëri demokratike. KPM është rregullator i mediave, jo gjykatë që shqyrton përgjegjësinë për shpifje apo ofendim ndaj palëve të treta. Detyra e KPM-së është të vlerësojë nëse mediami ka respektuar standardet profesionale: a ka ndërhyrë moderator i kur ka qenë e nevojshme, a është dhënë mundësi për përgjigje, a është bërë dallim mes faktit dhe opinionit, a është ruajtur balanca dhe a është vepruar me kujdes editorial. Por, KPM nuk ka kompetencë të konstatojë vetë se një deklaratë është shpifje, e

pavërtetë apo dëmtuese për reputacionin e dikujt. Këto janë çështje që mund të iniciohen me padi civile nga palët që potencialisht mund të konsiderojnë se iu është cenuar ndonjë e drejtë dhe atë përmes rrugëve gjyqësore. Pikërisht këtu qëndron problemi. Në vend se të analizojë sjelljen editoriale të mediumit, KPM po shqyrton përmbajtjen e deklaratave të të ftuarve dhe po i dënon mediat sikur ato të ishin autorë të deklaratave", është thënë në reagimin e IKD-së, duke shtuar se kjo e kthen përgjegjësinë editoriale në përgjegjësi objektive, standard ky që bie ndesh me lirinë e medias dhe me parimet themelore të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas IKD-së, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) ka vendosur qartë se ndëshkimi i gazetarit për përhapjen e deklaratave të bëra nga një person tjetër në intervistë e pengon seriozisht rolin e medieve në debat publik dhe mund të arsyetohet vetëm kur ka arsye veçanërisht të forta (Jersild kundër Danimarkës, §35). Po ashtu, sipas IKD-së, GjEDNJ ka theksuar se nuk mund të kërkohej nga gazetarët që sistematikisht dhe formalisht të distancohen nga çdo citim që mund të provokojë, fyejë apo dëmtojë reputacionin e dikujt (Thoma kundër Luksemburgut, §64).

"Në të njëjtën frymë, GjEDNJ ka konstatuar se përgjegjësia objektive për përmbajtje të palëve të treta, pa balancim mes lirisë së shprehjes dhe reputacionit, cenon nenin 10 të Konventës (Magyar Jeti Zrt kundër Hungarisë, §83). Për më tepër, në çështje të tilla duhet bërë dallim i qartë mes fakteve dhe gjykimeve vlerësuese. GjEDNJ ka theksuar se faktet mund të provohen, ndërsa e vërteta e gjykimeve vlerësuese nuk është e provueshme në të njëjtën mënyrë (Lingens kundër Austrisë, §46). KPM nuk mund ta shmangë këtë



test dhe të sillet sikur çdo deklaratë e rëndë politike është automatikisht shkelje e mediumit. Në këtë drejtim IKD fton kryetarin dhe anëtarët e KPM t'i kthehen ligjshmërisë dhe misionit të tyre për të ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre vetëm në bazë të ligjit dhe brenda autorizimeve dhe kompetencave që ofron Kushtetuta dhe ligji i aplikueshëm në Kosovë", thuhet në këtë reagim.

IKD-ja rithekson se gjuha fyese, sulmet personale dhe pretendimet e rënda në hapësirën publike nuk duhet të normalizohen. "Mediat kanë përgjegjësi profesionale për mënyrën se si i trajtojnë këto deklarata. Por kjo përgjegjësi nuk mund të kthehet në ndëshkim automatik. Nëse dikush pretendon se është shpifur, rruga ligjore është gjykata. Nëse KPM vlerëson se mediami nuk ka respektuar standardet editoriale, atëherë duhet ta provojë konkretisht dështimin editorial dhe proporcionalitetin e masës dhe jo automatikisht të sanksionojë mediat. Në anën tjetër, IKD ka parë me shqetësim edhe paralajmërimet për ndalimin e emisionit DEBAT PLUS të TV Dukagjini, paralajmërim që erdhi në formë të kërcënimit. Ai rast ishte skandaloz dhe shpërfaqti mendësinë problematike me të cilën KPM po i qaset mediave: fillimisht paralajmërohet masa, pastaj kërkohej arsyetimi. Në një demokraci, kjo logjikë është e rrezikshme. Megjithatë, problemi

nuk është vetëm tek ky rast. Vendimet e fundit të KPM-së tregojnë një praktikë më të gjerë të veprimit jashtë kufijve të mandatit ligjor, me arsyetime të dobëta, pa test real proporcionaliteti dhe me qasje ndëshkuese ndaj mediave. Ky nuk është rregullim ligjor i tregut medial, por presion institucional ndaj debatit publik", ka theksuar IKD-ja.

IKD i bën thirrje KPM-së që ta luajë rolin e saj kushtetues dhe ligjor si rregullator, jo si gjykatë. "KPM duhet ta kthejë ligjshmërinë në vendimmarrjen e saj, përfshirë vendimet e kundërligjshme për shkak të tejkalimit të afateve dhe procedurave të ndërlidhura me rekomandimet e Zyrës Ekzekutive të udhëhequr nga ushtrues detyre jashtë standardeve ligjore. KPM duhet të heqë dorë nga qasja armiqësore ndaj mediave dhe të veprojë vetëm mbi bazën e ligjit, fakteve, procedurës së rregullt dhe standardeve evropiane për lirinë e medias. IKD i bën thirrje KPM-së që urgjentisht të përfundojë procedurën për zgjedhjen e kryeshefit ekzekutiv, në përputhje me ligjin dhe përmes një procesi meritot. Vazhdimi i ushtrimit të kësaj pozite përmes ushtruesve të detyrës cenon ligjshmërinë, funksionalitetin dhe besueshmërinë e vendimmarrjes së KPM-së. IKD kërkon përgjegjësi dhe llogaridhënie edhe nga Kuvendi i Kosovës, i cili ende nuk e ka funksionalizuar Bordin e Ankesave ndaj vendimeve të KPM-së. Mosfunksionalizimi i

këtij mekanizmi ua cenon mediave të drejtën për mjet efektiv juridik dhe e lë vendimmarrjen e KPM-së pa kontrollin e nevojshëm institucional brenda procedurës administrative. IKD i bën thirrje legjislaturës së ardhshme që, në emërimin e personave në institucionet e pavarura, të udhëhiqen vetëm nga kriteret e integritetit personal, profesionalizmit dhe pavarësisë. Institucionet e pavarura nuk guxojnë të mbushen me persona që marrin vendime të kundërligjshme, cenojnë lirinë e mediave dhe e kthejnë rregullatorin në instrument presioni ndaj debatit publik", është theksuar në reagimin e IKD-së.

Në lidhje me këtë çështje kanë reaguar një ditë më parë edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës. "KMSHK i bën thirrje KPM-së që të ruajë pavarësinë dhe të gjykojë drejt, në përputhje me standardet e Kodit të Etikës të KPM-së. KMSHK, po ashtu, u bën thirrje anëtarëve të KPM-së të përmbahen nga deklaratat e pamatura dhe të pabazuara për cilësinë e raportimeve në mediat e vendit. Deklarata të tilla paralajmëruese dhe të pabazuara përbëjnë presion të drejtpërdrejtë ndaj lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave. KMSHK u bën thirrje anëtarëve të tjerë të KPM-së që të distancohen publikisht nga nisma të tilla, të cilat ndikojnë seriozisht në lirinë e mediave në vend", është theksuar në reagimin e KMSHK-së.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PREJ 8.78 MILIONË FRANGASH PËR TRANSFORMIMIN E GJELBËR TË BIZNESEVE

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, së bashku me ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jürg Sprecher, kanë nënshkruar marrëveshjen pesëvjeçare për zbatimin e projektit "Transformimi i Gjellbër i Ndërmarrjeve Private në Kosovë (GPEK)". Marrëveshja është realizuar ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), me bashkëfinancim nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), dhe do të

zbatohet gjatë viteve 2026-2031. Përmes këtij projekti, me vlerë të përgjithshme prej 8.78 milionë frangash zvicerane, synohet mbështetja e tranzicionit të gjellbër të sektorit privat në Kosovë, me fokus në rritjen e konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë klimatike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Projekti do të kontribuojë në promovimin e teknologjive më të pastra, rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve, adoptimin e praktikave të qëndrueshme të biznesit dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillim ekonomik. Ministria Kusari-Lila theksoi se



transformimi i gjellbër i industrisë dhe ekonomisë është një nga

prioritetet strategjike të ministrisë, duke shtuar se investimet në

inovacion, teknologji të qëndrueshme dhe zhvillim të sektorit privat janë thelbësore për rritjen ekonomike afatgjatë të vendit. Sipas saj, projekti do të ndihmojë në fuqizimin e ndërmarrjeve vendore, promovimin e investimeve të gjelbra, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përfshirjen më të madhe të kategorive të nënperfaqësuar në zhvillimin ekonomik.

Me këtë rast, ministria falënderoi Qeverinë e Zvicrës, SDC-në, SIDA-n dhe partnerët e tjerë për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës dhe besimin në potencialin zhvillimor dhe ekonomik të vendit.

AKK dhe Kongresi i Këshillit të Evropës zotohen për forcimin e qeverisjes lokale

Prishtinë, 11 qershor - Drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Sazan Ibrahim, ka takuar Mathieu Morin, sekretarin e përgjithshëm të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës në Strasburg, Francë.

Gjatë takimit Ibrahim i informoi për funksionimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës, rolin dhe aktivitetet e saj si dhe për funksionimin e

komunave në Kosovë.

Njëkohësisht ai e falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme që Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale i Këshillit të Evropës u ka ofruar AKK-së dhe komunave të Kosovës, veçanërisht në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira evropiane lidhur me funksionimin e pushtetit lokal dhe zbatimin e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale.

Në anën tjetër, Mori ka shprehur gatishmërinë për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit me Asociacionin e Komunave të Kosovës për fuqizimin dhe avancimin e qeverisjes lokale në Kosovë. Bashkëpunimi me Kongresin mbetet i një rëndësie të veçantë për forcimin e demokracisë lokale, avancimin e vetëqeverisjes lokale dhe zhvillimin e kapaciteteve të komunave në Kosovë.



GJYKATA SUPREME SHFUQIZON Pjesërisht RREGULLAT PËR XHAMAT E ERRËT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës, në çështjen juridike të konfliktit administrativ sipas padisë së organizatës joqeveritare "Marakli t'Kerreve" dhe Institutit "TriPika - Sport, Sociale, Ekonomi", kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, me objekt shqyrtimi të ligjshmërisë së nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 12/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 04/2023 për Regjistrimin e Mjeteve, pas shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur më 4 qershor 2026, ka aprovuar pjesërisht si të themeltë kërkesëpadinë e paditësve.

Me aktgjykim, Gjykata Supreme ka shpallur të paligjshëm dhe ka shfuqizuar paragrafin 1, paragrafin 3 dhe paragrafin 4 të nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 12/2024, ndërsa ka refuzuar

kërkesëpadinë lidhur me paragrafin 2 të të njëjtit nen.

Gjykata ka konstatuar se Ligji nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe Ligji nr. 05/L-132 për Automjete nuk përmbajnë ndalim të përgjithshëm për vendosjen e materialeve errësuese apo zëvendësimin e xhamave të automjeteve me xhama të errësuar. Përkundrazi, legjislacioni në fuqi parashikon mundësinë e modifikimeve në automjete, me kusht që ato t'i nënshtrohen procedurave të verifikimit teknik dhe atestimit sipas standardeve të përcaktuara me ligj.

Sipas vlerësimit të gjykatës, paragrafi 1 i nenit 7 vendoste një kufizim që nuk gjendet në ligj, duke lejuar xhamat e errët vetëm për automjetet që i kanë të instaluar nga prodhuesi, ndërsa paragrafi 3 ndalonte në mënyrë të përgjithshme vendosjen e folieve errësuese në xhamat e automjeteve.

Gjykata vlerësoi se këto dispozita nuk përbënin thjesht



zbatim apo konkretizim të ligjit, por krijonin kufizime të reja materiale që ligjvënësi nuk i kishte paraparë.

Po ashtu, gjykata konstatoi se paragrafi 4, i cili parashihte lejimin e përjashtimeve me vendim të Ministrit të Punëve të Brendshme, ishte i lidhur ngushtë me ndalimin e

parashikuar në paragrafin 3 dhe, për rrjedhojë, nuk mund të qëndronte në fuqi pasi vetë ndalimi bazë rezultoi i paligjshëm.

Në vendimin e saj, gjykata ka theksuar se organet administrative mund të nxjerrin akte nënligjore vetëm për të zbatuar dhe konkretizuar ligjin,

por jo për të krijuar ndalime apo kufizime të reja që nuk burojnë nga dispozitat ligjore.

Çdo kufizim i të drejtave ose i mundësive të përdorimit të automjeteve duhet të mbështetet në autorizim të qartë ligjor dhe të respektojë parimet e ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe proporcionalitetit.

Gjykata ka vlerësuar se dispozitat e shfuqizuara krijojnë trajtim të ndryshëm për automjete që ndodhen në situata të krahasueshme, pa një bazë të qartë ligjore dhe pa u dëshmuar nevoja për një dallim të tillë në funksion të mbrojtjes së interesit publik.

Ndërkaq, sa i përket paragrafit 2 të nenit 7, gjykata ka gjetur se ai përbën një dispozitë administrative dhe teknike që rregullon evidentimin e xhamave të errët në dokumentacionin e regjistrimit të automjetit dhe nuk vendos kufizime apo ndalime që bien ndesh me ligjin. Për këtë arsye, kjo dispozitë ka mbetur në fuqi.

KURTI DHE ZYRTARËT E LV-SË BËJNË HOMAZHE PËR ARBËNOR DEHARIN NË PËRVJETORIN E TIJ



PRISHTINË, 11 QERSHOR - Në kuadër të ditës së dytë të "Javës së Lëvizjes", Lëvizja Vetëvendosje ka përkujtuar aktivistin e saj të ndjerë, Arbënor Dehari.

Kryeministri në detyrë dhe kryetari i LV-së, Albin Kurti, së bashku me sekretarin organizativ të LV-së, Alim Rama, ministra, zyrtarë dhe aktivistë të kësaj partie, vizituan familjen Dehari dhe më pas bënë homazhe te varri i Arbënor Deharit.

Në njoftimin e LV-së, Dehari përshkruhet si aktivist dhe shembull i angazhimit politik, kujtimi i të cilit vazhdon të mbetet i gjallë brenda organizatës. "Përvjetori i Arbënor Deharit. Në ditën e dytë të Javës së Lëvizjes, kujtojmë aktivistin, shokun dhe njeriun që vazhdon të mbetet shembull i angazhimit politik brenda organizatës sonë, Arbënor Dehari. Sot, Kryeministri Albin Kurti, bashkë me sekretarin organizativ Alim Rama,

ministra, zyrtarë të Lëvizjes dhe aktivistë, vizituan familjen Dehari, për të vazhduar më pas homazhet te varri i Arbënorit. Kujtimi për Arbënorin mbetet i gjallë dhe aktiv, i mishëruar në çdo iniciativë tonën dhe në çdo kauzë të drejtë që përqafojmë. Arbënori na mësoi se idealizmi nuk është larg realitetit; përkundrazi, është forca që e ndryshon atë. Përjetësisht me ne, në zemrat dhe mendjet tona, Arbënor Dehari", ka njoftuar LV-ja.

Kryetari i Kushtetueses dhe ambasadori hungarez diskutojnë për gjyqësinë kushtetuese të Kosovës

Prishtinë, 11 qershor - Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, Nexhmi Rexhepi, ka prituri në takim ambasadorin e Republikës së Hungarisë në Kosovë, Laszlo Istvan Dux. Temë e diskutimit

të përbashkët ishin zhvillimet e fundit në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës, roli dhe rëndësia që kanë gjykatat kushtetuese të të dyja vendeve në zhvillimin e demokracisë si dhe domosdoshmëria e

pavarësisë institucionale të tyre.

Kryetari Rexhepi vuri theksin në rolin konstruktiv të Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë në përpjekjet për anëtarësimin e Gjykatës

Kushtetuese të Kosovës në forumet evropiane të gjykatave kushtetuese dhe shprehur gatishmërinë për thellimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit në të ardhmen.



BQK-ja DHE ATK-ja NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR AVANCIMIN E SHKËMBIMIT TË INFORMACIONIT DHE FORCIMIN E INTEGRITETIT FINANCIAR

Prishtinë, 11 qershor - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, dhe drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Mentor Hyseni, kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, me qëllim forcimin e koordinimit institucional, avancimin e shkëmbimit të informacionit dhe mbështetjen e mekanizmave që kontribuojnë në stabilitetin, sovranitetin, integritetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe ekonomik në Republikën e Kosovës. Marrëveshja përcakton kornizën kryesore të bashkëpunimit ndërmjet BQK-së dhe ATK-së në fushat me interes të përbashkët, në përputhje me mandatet ligjore dhe legjislativonin në fuqi. Ajo krijon një bazë më të

strukturuar për shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve relevante, koordinimin e aktiviteteve institucionale dhe mbështetjen e analizave që lidhen me stabilitetin financiar, zhvillimet makroekonomike, luftimin e ekonomisë joformale dhe adresimin e veprimtarive që mund ta cenojnë integritetin financiar apo ekonomik të vendit.

Për BQK-në, marrëveshja forcon qasjen në informacione relevante për mbikëqyrjen financiare, analizën institucionale dhe vlerësimin e zhvillimeve që lidhen me stabilitetin dhe integritetin financiar. Për ATK-në ajo mbështet administrimin tatimor, analizën e rrezikut dhe identifikimin më efikas të veprimtarive joformale apo shmangieve fiskale. Për të dy



institucionet, marrëveshja rrit cilësinë e bashkëpunimit, shmang fragmentimin institucional dhe mundëson reagim më të koordinuar ndaj çështjeve me interes të përbashkët.

Aspektet teknike, mënyrat e zbatimit, format e shkëmbimit të të dhënave, përgjegjësitë operative dhe çështjet e tjera të nevojshme për zbatimin praktik të marrëveshjes do të

përcaktohen përmes procedurave standarde operative në përputhje me kërkesat ligjore. Duke marrë parasysh zhvillimet në sektorin financiar, digjitalizimin e shërbimeve financiare, avancimin e infrastrukturës së pagesave dhe proceset e integritetit të mëtejshëm të Kosovës në tregjet financiare evropiane, kjo marrëveshje paraqet një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit institucional dhe rritjes së kapaciteteve për adresimin e sfidave të përbashkëta.

BQK-ja dhe ATK-ja mbeten të përkushtuara që, përmes kësaj marrëveshjeje, të kontribuojnë në forcimin e integritetit financiar, mbrojtjen e interesit publik dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Republikës së Kosovës.

BQK-ja DHE THESARI I SHBA-SË THELLOJNË BASHKËPUNIMIN PËR AML/CFT

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, ka pritur një Mision të Asistencës Teknike në kuadër të projektit të ri të Zyrës për Asistencë Teknike (OTA) të Departamentit të Thesarit të ShBA-së, të udhëhequr nga ekspertët Joseph W. Burke dhe Norman Smith.

Misioni u fokusua në forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale dhe ekspertizës mbikëqyrëse të BQK-së në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (AML/CFT), duke u mbështetur në bashkëpunimin e vazhdueshëm me Thesarin e ShBA-së dhe takimet e nivelit të lartë të mbajtura në Uashington D. C. gjatë takimeve pranverore në prill 2026 si dhe kërkesën e BQK-së të dorëzuar në dhjetor 2024.

Guvernatori Ismaili paraqiti një pasqyrë të mandatit, detyrave dhe përgjegjësi të BQK-së, me theks të veçantë në rolin e saj në ruajtjen e integritetit të sistemit



financiar, forcimin e mbikëqyrjes AML/CFT dhe luftimin e falsifikimit të monedhës. Ai theksoi reformat kryesore të ndërmarra nga BQK-ja për ta rritur integritetin financiar, qëndrueshmërinë institucionale dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare.

Gjatë takimit guvernatori Ismaili përmendi përparimin e arritur në avancimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse, përfshirë zbatimin e vazhdueshëm të mbikëqyrjes të bazuar në rrezik,

hartimin e rregulloreve për krypto-asetet dhe licencimin e ofruesve të shërbimeve të krypto-aseteve si dhe forcimin e mekanizmave të shqyrtimit të investimeve për institucionet e reja që hyjnë në tregun e Kosovës. Diskutimet përfshinë gjithashtu përmirësimin e mëtejshëm të praktikave të mbikëqyrjes së institucioneve financiare dhe procedurave të përshtatshme dhe integritetit (fit-and-proper).

Një pjesë e rëndësishme e diskutimit u fokusua në projektin

e ri që do të zbatohet në bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Financave, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Njësisë së Inteligjencës Financiare dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Projekti synon forcimin e kornizës së integritetit financiar të Kosovës përmes mbështetjes këshilluese nga ekspertë në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Luftimit të Financimit të Terrorizmit dhe Financimit të Përhapjes (AML/CFT/CPF). Kjo

nismë është dizajnuar për ta rritur koordinimin ndërinstitucional, për ta forcuar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe për ta përmirësuar efektivitetin e përgjithshëm të kornizës së Kosovës për parandalimin dhe adresimin e rreziqeve të krimit financiar. Me këtë rast, guvernatori Ismaili nënshkroi Termat e Referencës për projektin, duke riafirmuar përkushtimin e BQK-së për avancimin e kornizës kombëtare AML/CFT/CPF, forcimin e bashkëpunimit institucional dhe kontributin në mbrojtjen e sistemit financiar të Kosovës.

Guvernatori Ismaili shprehu mirënjohje të thellë ndaj Departamentit të Thesarit të ShBA-së për mbështetjen e vazhdueshme, asistencën teknike dhe bashkëpunimin institucional. Ai vlerësoi lart rolin e Thesarit të ShBA-së në forcimin e funksioneve thelbësore të BQK-së, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe mbështetjen e ruajtjes së integritetit financiar në Republikën e Kosovës.

BE-ja po i ndihmon bizneset e Kosovës t'i rrisin eksportet në tregun e BE-së

Prishtinë, 11 qershor - Shefi i Sektorit Politik i BE-së në Kosovë, Boguslaë Gertruda, iu bashkua të enjten ministres në detyrë, Mimoza Kusari-Lila, në shënimin e Ditës Botërore të Akreditimit në një aktivitet të organizuar nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës.

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës ka aplikuar për t'u bërë nënshkruese e

Marrëveshjes Shumëpalëshe të Akreditimit Evropian (EAMLA), një sistem që siguron njohjen reciproke të vlerësimeve të konformitetit të produkteve të kryera nga organet e akredituara në të gjithë Evropën. Ky anëtarësim do ta zvogëlonte nevojën për testim dhe certifikime të dyfishta, duke e bërë më të lehtë për produktet e Kosovës qasjen

në tregun e BE-së. "BE-ja në Kosovë do ta mbështesë Drejtorinë e Akreditimit të Kosovës, organet e vlerësimit të konformitetit të produkteve dhe kompanitë private eksportuese në përpjekjet e tyre për t'u përputhur me rregullat dhe standardet e BE-së, duke ndihmuar në hapjen e rrugës për integrimin e Kosovës në zinxhirët e vlerës industriale

të BE-së", ka thënë Gertruda. Me mbi 3.7 miliardë euro të investuara që nga viti 1999, BE-ja mbetet partneri më i fortë i Kosovës dhe ofruesi më i madh i ndihmës financiare.

Plani i Rritjes i BE-së dhe zbatimi i Agjendës së Reformës i ofrojnë Kosovës një mundësi unike për t'u integruar gradualisht në Tregun e Përbashkët të BE-së,



duke krijuar mundësi të reja për bizneset, ekonominë dhe qytetarët.

RONALDO-MESSI: VALLJA E FUNDIT E TË PAVDEKSHMËVE

Cristiano për herë të parë. Leo për ta provuar sërish pas triumfit në Katar. Të vetmit ende në fushë në Kupat e Botës që nga viti 2006. Yamal dhe Endrick ende nuk kishin lindur; nga nesër do të përpiqen t'u marrin fronin



Katër vjet më parë, në Katar, ishte vjeshta e Messit dhe Ronaldos: dukej si ajo e perëndive të vdekshme, e zbehjes, e fundit të një epoke. Flitej për Botërorin e tyre të fundit, ndërsa Leo kalonte ndeshjet e para duke ecur (dhe duke shëtitur kundër Arabisë Saudite) dhe Cristiano, i saposhkarkuar nga Manchester United, për herë të parë në jetën e tij përfundonte në stol për zgjedhje teknike, madje pothuajse si ndëshkim (kishte protestuar publikisht për zëvendësimin në ndeshjen e mëparshme).

Argjentinasi dukej në prag të dështimit. Portugezi në pikën më të ulët të karrierës së tij. Zëvendësuesi Gonçalo Ramos shënonte tripletë, ndërsa në Lisbonë shtoheshin sondazhet, sipas të cilave tifozët portugezë mendonin se CR7 ishte tashmë më shumë problem sesa zgjidhje.

Katër vjet më vonë jemi ende këtu.

Katari ishte e parafundit, jo e fundit, siç mendonim. Messi fajësoi veten dhe shokët e ekipit, vrapoi si i çmendur për t'i mbyllur gojën kritikëve dhe u bë kampion bote, duke shpërndarë nëpër botë buzëqeshjet e tij të mrekullueshme. Më pas u rikthye te Parisi dhe vazhdoi të ecë në fushë.

Portugalia doli sërish në çerekfinale, por Ronaldo hyri nga dera kryesore: ajo e sakrificës. I përjashtuar nga formacioni, ai pa vendin e tij të merrej nga Martínez, që mbeti në qendër të projektit kombëtar. Në vendin e tij, Cristiano është ende ai që mallkohet dhe njëkohësisht adhurohet, por me një pjekuri që askush nuk ia kishte njohur më parë. Kombëtarja nuk luan më për të, por me të. Lojtarët që drejtojnë fatin e Portugalisë janë Vítinha, João Neves, Bernardo Silva,

Bruno Fernandes (mesfushori më i fortë i Botërorit) dhe ai i ndjek me përkushtim.

Ronaldo-Messi: Vallja e fundit e kampionëve

Argjentina vazhdon të mbështetet te Messi. Portugalia ka mësuar të fitojë edhe pa të. Dhe ja ku është ndryshimi: cikli i Leos duket se nuk mbaron kurrë, ndërsa ai i Cristiano-s ka hyrë në një kohë që nuk do të duhej të ekzistonte.

Jo se njëri apo tjetri kanë humbur nuancat e përjetësisë, edhe nëse kjo do të jetë vërtet hera e fundit.

Vërtet e fundit?

Messi mbush 39 vjeç në 24 qershor. Ronaldo i ka mbushur 41. Të dy do të luajnë Kupën e tyre të gjashtë të Botës, duke vendosur dhe ndarë një rekord

me portierin mexikan Ochoa (i cili, megjithatë, në vitet 2006 dhe 2010 nuk zbriti në fushë).

Dhe do të ketë shumë nga ata që do të përpiqen t'i imitojnë në jetëgjatësi, po aq sa edhe në madhësi.

Kur Leo dhe Cristiano debutuan në Botëror (Gjermani 2006), Lamine Yamal nuk kishte lindur ende (madje as nuk ishte konceptuar). Ai përfaqëson brezin e atyre që për herë të parë mund të çlirohen nga kompleksi i inferioritetit ndaj dy legjendave që kanë fituar pothuajse gjithçka, si me kombëtaren (Botëror, European, Copa América, Nations League), ashtu edhe në nivel klubesh e individual.

Brezi i tyre dhe ai i njëzetvjeçarëve është tashmë në moshën e duhur. Mjafton të kujtojmë se vetëm dy fituesit e Topit të Artë në vitet 2024 dhe 2025, Rodri dhe Dembélé, nuk e fituan si ikonat e City-t apo PSG-

së, por si pjesë e një kolektivi.

Pas Messit dhe Ronaldos janë vetëm Yamal, Modrić dhe Benzema nga brezi i tyre.

Luka është ende këtu (për Botërorin e tij të pestë), sipas të gjitha gjasave edhe në të dyzetat (siç do të bëhet javën e ardhshme), ndërsa nën të njëzetat, përveç Lamine-s, janë djemtë e Ancelottit, Endrick dhe Raya, marokeni Bouaddi, që vetëm pak javë më parë zgjodhi të përfaqësojë vendin e origjinës dhe jo Francën ku ka lindur e është rritur, spanjulli Diomande (që luan te Leipzig), lojtari i PSG-së dhe ylli i ri brazilian Mora.

Të gjithë të mitur në turne. Me përjashtim të Karl-it, i cili u thirr në këtë momentet e fundit, por do të ketë gjithsesi kohën e tij.

Ajo që po mbaron për Messin dhe Ronaldon, për ata që duhet t'i pasonin (Mbappé, Haaland, Kane, për të mos folur për Neymarin), ende nuk ka ardhur. / bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

“Dardanet” U17 dhe U19 mësojnë kundërshtaret për kualifikimet evropiane

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Kombëtarja e Kosovës U17 dhe ajo U19 në konkurrencën e vazhduar kanë mësuar

kundërshtaret për kualifikimet evropiane. Siç ka njoftuar Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), “Dardanet”

U17 janë shortuar në Grupin B1, ku do të përballen me Shqipërinë, Republikën e Irlandës dhe Azerbajxhanin,

ndërsa “Dardanet” U19 janë përfshirë në Grupin A3, ku bëjnë pjesë Polonia, Greqia dhe Sllovakia.



ADEMI: KOSOVA PO NDËRTON THEMELE TË FORTA PËR TË ARDHMEN E FUTBOLLIT

MEKSIKO CITY, 11 QERSHOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka njoftuar se me ftesë të presidentit të FIFA-s, Gianni Infantino, ka marrë pjesë në ndeshjen hapëse të Kupës së Botës 2026, Meksikë - Afrika e Jugut dhe më vonë do të jetë pjesë e Samitit të FIFA-s që do të mbahet në Majami. Ademi ka thënë se vizita ka edhe simbolikë të veçantë për futbollin e Kosovës, pasi vjen në një qytet ku, sipas tij, “para dhjetë vjetësh Kosova u pranua

në familjen botërore të futbollit”. Nga Meksika, presidenti i FFK-së ka përgëzuar edhe përfaqësuesen e femrave për kualifikimin në “play-off”-in e Botërorit 2027, duke e cilësuar atë si “një sukses që na bën krenarë të gjithëve”. “Besoj fuqishëm se me punën, përkushtimin dhe talentin që kanë djemtë dhe vajzat tona, edhe Kosova shumë shpejt do të jetë pjesë e ngjarjeve të tilla madhore të futbollit botëror”, ka thënë Ademi. Ai ka vlerësuar strategjinë

zhvillimore të FFK-së, duke theksuar se projektet në futbollin e femrave dhe në zhvillimin e talenteve të rinj “po japin rezultatet e para konkrete”. Sipas Ademit, Akademia e FIFA-s në Prishtinë, e para e këtij lloji në Ballkan, po kontribuon në formimin profesional të talentëve të Kosovës nën drejtimin e ekspertëve të FIFA-s dhe stafit teknik vendor. “Jam shumë i lumtur që strategjia dhe projektet zhvillimore të FFK-së po implementohen me sukses dhe

tashmë po japin rezultatet e para konkrete si në futbollin e femrave, edhe në zhvillimin e talenteve të rinj. Akademia e FIFA-s në Prishtinë, e para e këtij lloji në Ballkan, po jep frytet e saj, ku talentet tona po marrin formimin më të mirë profesional nën udhëheqjen e ekspertit të FIFA-s dhe stafit tonë teknik. Kjo është dëshmi se investimi në të rinjtë dhe puna e vazhdueshme po ndërtojnë themele të forta për të ardhmen e futbollit të Kosovës”, ka thënë Ademi.



KOSOVËS I MOHOHEN SIMBOLET SHTETËRORE NË KAMPIONATIN EVROPIANIN TË GOLFIT NË QIPRO, FGK-JA REFUZON PJESËMARRJEN

Prishtinë, 11 qershor - Federata e Golfit e Kosovës (FGK) nuk do të marrë pjesë në Kampionatin Evropian të Seniorëve 2026 i cili ka nisur të enjten në Paphos të Qipros për shkak të një vendimi të autoriteteve shtetërore të Qipros, të mbështetur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së këtij vendi, ku është



thënë se Kosova nuk mund të paraqitet me simbolet shtetërore.

FGK-ja ka shprehur keqardhjen e thellë për këtë vendim dhe ka njoftuar se me këto kushte nuk do të marrë pjesë në kampionat. “Më 27 maj 2026, vetëm pak ditë para kampionatit, u informuam se për shkak të një vendimi të autoriteteve shtetërore të Qipros, të mbështetur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe

Rinisë së Republikës së Qipros, nuk do të lejohej paraqitja e Republikës së Kosovës me simbolet e saj shtetërore në mënyrë të barabartë me shtetet e tjera pjesëmarrëse. Konkretisht, flamuri shtetëror i Republikës së Kosovës nuk do të mund të shfaqej në vendin e garës në të njëjtën mënyrë si flamujt e 28 shteteve të tjera

pjesëmarrëse”, ka njoftuar FGK-ja. Federata e Golfit e Kosovës (FGK) ka theksuar se, bazuar në këtë vendim, ekipi i Kosovës nuk pranon të marrë pjesë në gara ndërkombëtare “në kushte të pabarabarta dhe pa të drejtën për ta përfaqësuar shtetin me identitetin dhe simbolet zyrtare”.

REKORDET E KUPËS SË BOTËS, MESSI DHE MBAPPE “KËRCËNOJNË” DISA PREJ ARRITJEVE HISTORIKE

NJU-JORK, 11 QERSHOR - Kupa e Botës ka qenë gjithmonë skena ku janë vendosur dhe thyer rekordet më të mëdha të futbollit. Edicioni i vitit 2026 mund të sjellë kapituj të rinj në histori, me emra si Lionel Messi, Cristiano Ronaldo dhe Kylian Mbappe që synojnë të lënë gjurmë të tjera të paharrueshme. Messi, Ronaldo dhe portieri meksikan Guillermo Ochoa kanë hyrë në histori si futbollistët e vetëm që kanë marrë pjesë në gjashtë edicione të Kupës së

Botës, një arritje që kërkon më shumë se dy dekada karrierë në nivelet më të larta. Një tjetër rekord që mund të bjerë është ai i golashënuesit më të mirë në historinë e botërore. Gjermani Miroslav Klose mban vendin e parë me 16 gola, por Kylian Mbappé është shumë pranë, me 12 gola në vetëm dy edicione. Edhe Messi, me 13 gola, ka ende shanse ta barazojë ose ta kalojë rekordin në turneun e fundit të karrierës së tij. Ndërkohë, rekordi i Just Fontaine

prej 13 golash në një edicion të vetëm të Kupës së Botës, vendosur në vitin 1958, vazhdon të duket pothuajse i paarrtshëm. As Ronaldo në vitin 2002 dhe as Mbappe në vitin 2022 nuk shkuan më shumë se 8 gola në një turne. Po aq i vështirë për t'u thyer mbetet edhe rekordi i legjendës braziliane Pelé, i vetmi futbollist që ka fituar tri Kupa Bote në vitet 1958, 1962 dhe 1970. Cristiano Ronaldo kryeson gjithashtu listën e futbollistëve që kanë

shënuar në më shumë edicione të Botërorit, me gola në pesë turne të ndryshëm. Messi e ndjek me katër dhe synon ta ngushtojë diferencën në vitin 2026. Mes rekordeve më të veçanta janë edhe pesë golat e Oleg Salenkos në një ndeshje të vetme të Botërorit në vitin 1994 si dhe goli më i shpejtë në histori, përcjell tch, i realizuar nga Hakan Şükür pas vetëm 11 sekondash në vitin 2002. Me zgjerimin e Kupës së Botës në 48 skuadra dhe më shumë ndeshje në kalendar, disa



rekorde historike mund të vihen seriozisht në rrezik, ndërsa të tjerë vazhdojnë të duken të paprekshëm edhe pas dekadash.



Ylber Ramadani rinovon kontratën me Leccen deri në vitin 2027

Lece, 11 qershor - Mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë, Ylber Ramadani, do të vazhdojë të jetë pjesë e U. S. Lecce edhe për dy vjet të tjera. Klubi italian ka konfirmuar zyrtarisht rinovimin e kontratës së Ramadani deri në verën e vitit 2027, duke i dhënë

fund çdo dyshimi rreth të ardhmes së tij. Lajmi nuk vjen si surprizë, pasi raportimet për vazhdimin e bashkëpunimit mes palëve kishin qarkulluar që në janar të këtij viti. Tashmë marrëveshja është finalizuar dhe zyrtarizuar nga klubi i Serisë A.

Ramadani ka qenë një nga lojtarët më të rëndësishëm të Lecces në sezonet e fundit, duke u shndërruar në një pikë referimi në repartin e mesfushës falë paraqitjeve të tij të qëndrueshme dhe përvojës së fituar në futbollin italian. Me këtë

rinovim, Lecce siguron vazhdimësinë e një prej futbollistëve kyç të skuadrës, ndërsa Ramadani do ta ketë mundësinë ta vazhdojë aventurën në elitën e futbollit italian deri të paktën në vitin 2027.



NJOFTIM PËR KONTRATË

Kontratë Furnizimi Procedurë konkurruese me negociim

Në përputhje me nenin 12 "Procedurë konkurruese me negociim", të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (1 dhjetor 2024)

I BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS – BQK

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja:

"Furnizim me automjet transportues (furgon) të blinduar"

II.2 Numërtimi i Prokurimit: "BQK 26 051 113"

III VENDI I REALIZIMIT TË FURNIZIMIT

III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Objekti i BQK-së, rr. "Luan Haradinaj" nr. 2, 10000 Prishtinë

IV KRITERI PËR DHËNIE TË KONTRATËS

IV.1 "Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët" në përputhje me nenin 34 të Rregullës së prokurimit në BQK (për më tepër informata referojuni versionit të zgjeruar të njoftimit për kontratë publikuar në www.bqk-kos.org/shpallje/tenderet)

V INFORMATA ADMINISTRATIVE

V.1 Kushtet për marrjen e dokumentit për përzgjedhje/kërkesës për pjesëmarrje dhe informata të tjera administrative: Njoftimi për Kontratë i plotë dhe Dokumenti për Përzgjedhje është në dispozicion në ueb-faqen e BQK-së: <https://bqk-kos.org/shpalljet/tenderet/>.

Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga kandidatët/tenderuesit për sqarime shtesë, data: 19.06.2026 ora 16:00.

V.2 Vendi dhe afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve, data: 24.06.2026, ora 14:00; Adresa: objekti i BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. "Luan Haradinaj" nr. 2, Prishtinë;

V.3 Takimi për hapjen e kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve, data: 24.06.2026, ora 14:30; vendi: Objekti i BQK-së, Rr. "Luan Haradinaj" nr. 2, Prishtinë.

VI INFORMATA PLOTËSUESE

VI.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë është në dispozicion në ueb-faqen e BQK-së: www.bqk-kos.org

VII ANKESAT

Në përputhje me "Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Dhjetor 2024)", respektivisht sipas Neni 48 "Procedura e ankesës", çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t'u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.



Prishtinë, 03.06.2026

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „Elektro System“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 81050100 me adresë: Rr. „Adem Jashari“, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.05.2026 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej 0.57 MW ZK Prekallë, Komuna e Istogut, Republika e Kosovës.

Shoqëria „Elektro System“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 0.57 MW ZK Prekallë, Komuna e Istogut, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.6336-2/25 dt. 03.12.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturaes.
- Vendim për Caktimin e Kushteve Ndërtimore nr. 11-351-40062/145 dt. 21.11.2026 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Vendimi për Leje Ndërtimore Nr. 11-351-45958/158 dt. 30.12.2025 për "Instalimin e Sistemit Solar Fotovoltaik- me kapacitet 0.57 MW, ngastra katastrale 00371-6, dhe 00371-7 ZK Prekallë, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 5723 dt. 22.04.2026 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shfytjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inzhineri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shfrytëzohet në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: elektrosystem16@gmail.com dhe LEGAL@EBCENSING.com-kos.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për atë që ka lejon legjislativimi për Qasje në Dokumentet Publike.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Artiol Bekteshi shpall të pavlefshme dëftesën kl. 11 të shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Leona Dërmaku shpall të pavlefshme dëftesën kl. 10 të shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Eljesa Beqiri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Valentina Sulejmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- "Flemingo Kosovo" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810126278.

- Ensar Muriqi shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Jusuf Idrizi shpall të pavlefshme 3 dëftesat QK "11 Marsi" Prizren.

- Anita Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX sh.f.m.u. " Ibrahim Fehmiu" Prizren.

- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK "11 Marsi" Prizren.

- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.

- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë Fizioterapi.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Mazdrek.

- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.

- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- "Restorant te Besi" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.

Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.

- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Sulejman Vokshi" në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.

- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore "Ukshin Miftari", Skivjan-Gjakovë.

- Çlirim Gjuraj nga Gërqina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U "7 Shtatori", nga klasa e 6-9.
- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. "7 Shtatori" Prishtinë.

- Vilson Gjykej nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U "Engjëll Gjoni", Novosellë, nga klasa 1-8.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

